

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Mahir Tutuli, kryetar i kolegjit, Rafet Haxhaj dhe Qerim Ademaj, anëtarë, në çështjen juridike të propozuesit të sigurimit "[A...]" sh.p.k me seli në Ferizaj, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit [H.P], avokat në Prishtinë, ndaj kundërshtarit të sigurimit N.T.P. "[E...]" nga Vushtria, Rr. "[...]", p.n., të cilën sipas autorizimit e përfaqëson [K.B], avokat në Prishtinë, për shkak të caktimit të masës së sigurimit, duke vendosur lidhur me ankesën e propozuesit të masës së sigurimit, të parashtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë –Departamenti për Çështje Ekonomike, I.EK.nr. 143/2016, të datës 15.09.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur me dt. 24.10.2017, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET ankesa e propozuesit të masës së sigurimit "[A...]", sh.p.k., me seli në Ferizaj, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë –Departamenti për Çështje Ekonomike, I.EK.nr. 143/2016, i datës 15.09.2017, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Me aktvendimin e atakuar, gjykata e shkallës së parë e ka refuzuar si të pabazuar propozimin e propozuesit "[A...]" sh.p.k., me seli në Ferizaj, i paraqitur kundër kundërshtarit të masës së sigurisë N.P.T."[E...]" me seli në Vushtri për caktimin e masës së sigurisë, me të cilën ka kërkuar që t'i ndalohej kundërshtarit të sigurimit gjatë reklamimit apo shitjes së mallit të tij, ta përdor shenjën e markës "[V...]" dhe t'i heq nga tregu të gjitha produktet të cilat bartin shenjën "[V...]".

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë propozuesi i masës së sigurimit, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkallës së dyte ta prishë aktvendimin e ankimuar dhe ta aprovoj propozimin e palës propozuese dhe t'i ndalohej kundërshtarit të sigurimit përdorimi dhe vendosja e mëtuftjeshme e shenjës së markës "[V...]" në prodhimin e produkteve, qarkullimi i mallrave dhe produkteve në treg me shenjën "[V...]", ofrimi, shitja e këtyre dhe reklamimi i këtyre produkteve duk përdorur markën tregtare "[V...]" si dhe të detyrohet kundërshtari i sigurimit që të tërheq nga tregu mallin e plasuar në treg me shenjën "[V...]", deri në zgjidhjen e këtij kontesti me aktgjykim të formës së prerë, ose ta prish aktvendimin e ankimuar dhe çështjen t'ia kthej gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.

Në përgjigje në ankesë kundërshtari i masës së sigurisë ka propozuar që ankesa të refuzohet si e pabazuar dhe të vërtetohet aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike.

Pas vlerësimit të pretendimeve ankimore, aktvendimit të atakuar dhe shkresave të lëndës në pajtim me nenin 194 në lidhje me nenin 208 të LPK, Gjykata e Apelit ka gjetur se:

Ankesa është e pabazuar.

Propozuesi i masës së sigurisë "[A...]" sh.p.k, me datë ka paraqitur në gjykate padi për ndalimin e përdorimit të markës tregtare, me propozim për caktimin e masës së sigurisë ndaj kundër-propozuesit "[E...]" Sh.p.k., me seli në Vushtrri, me propozim që shkelësit të markës tregtare t'i ndalohet që të vendos dhe të përdor shenjën e markës tregtare "[V...]" të paditësit në mallrat dhe produktet e veta, largimin e mallit nga tregu, hedhjen dhe ofrimin për shtije apo reklamimin duke përdorur shenjën "[V...]", nga dita e marrjes së masës së përkohshme e deri në zgjidhjen e kësaj çështje juridike civile me aktgjykim të formës së prerë.

Gjykata e shkallës së parë duke vendosur sipas propozimit për caktimin e masës së sigurimit, me aktvendimin e atakuar, ka refuzuar si të pabazuar propozimin e palë propozuese për caktimin e masës së sigurisë me arsyetimin se propozimi i paraqitur nuk i ka plotësuar kushtet ligjore të parapara me Nenin 297.1 të LPK-së.

Gjykata e Apelit e pranon vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë me shkëlqje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.2, pika b), g), j), k) dhe m) të LPK e po ashtu drejtë është zbatuar edhe e drejta materiale, e të cilat shkaqe ankimore i vështron gjykata e shkallës së dytë sipas detyrës zyrtare e në bazë të nenit 194 të LPK.

Gjykata e apelit e mori këtë vlerësim juridik për arsye se sipas Nenit 297.1 nën pikën a) dhe b) të LPK-së parashihet se:” *Masa e sigurimit mund të caktohet: a) në qoftë se propozuesi i sigurimit e bënë të besueshme ekzistimin e kërkesës apo të së drejtës subjektive të tij , dhe b) në qoftë se ekziston rreziku se pa caktimin e masës së këtillë pala kundërshtarë do të mund ta pamundësonte apo vështirësonte dukshëm realizimin e kërkesës, sidomos me tjetërsimin e pasurisë së vet, me fshehjen e saj, me ngarkimin apo me ndonjë mënyrë tjetër, me të cilën do ta ndryshonte gjendjen ekzistuese të gjërave, ose në ndonjë mënyrë tjetër do të ndikonte negativisht në të drejtat e propozuesit të sigurimit.*

Bazuar në dispozitat e sipërcituara për caktimin e masës së sigurimit duhet të plotësohen kushtet ligjore sipas të cilave propozuesi i sigurimit duhet ta bëjë të besueshme ekzistimin e kërkesës si dhe ta bëjë të besueshme faktin se pa caktimin e masës së këtillë pala kundërshtarë do të mund ta pamundësonte apo vështirësonte dukshëm realizimin e kërkesës së tij. Në rastin konkret nga shkresat e lëndës rezulton se propozuesi i sigurimit në këtë fazë të procedurës, nuk ka ofruar prova bindëse lidhur me besueshmërinë e kërkesës së tij, me të cilat do të vërtetonte pretendimet tij lidhur me propozimin për caktimin e masës së sigurisë. Poashtu në rastin konkret nuk plotësohet as kushti i dytë ligjor për caktimin e masës së sigurimit sepse e paditësi nuk ka ofruar ndonjë provë se kundërshtarët e sigurimit do të mund të pamundësojnë apo vështirësojnë dukshëm realizimin e kërkesës, ose në ndonjë mënyrë tjetër do të ndikonte negativisht në të drejtat e propozuesit të sigurimit.

Kjo gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë ka vepruar drejtë dhe ka gjetur se propozimi është i pabazuar, ka mbështetje ligjore si dhe janë dhënë arsyet e justifikueshme të bazuara në shkresat e lëndës, të cilat i pranon edhe kjo gjykatë.

Gjykata i vlerësoi pretendimet ankimore të propozuesit të sigurimit por gjeti se të njëjtat nuk përbëjnë arsye që kanë mbështetje ligjore, e për të cilat duhet prishur aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë. Pretendimi i propozuesit për shkelje të markës tregtare nga ana e të paditurës në rastin konkret është i paqëndrueshëm sepse propozuesi me Vendimin Nr. Regj. [...], dt. 11.02.2016, e ka te regjistruar markën tregtare verbale “[V...]” ndërsa kundërshtari i sigurimit përdor në produktet e tij markën figurative “[S...]”, për të cilën është në procedurë të regjistrimit.

Meqenëse markat tregtare verbale gëzojnë mbrojtje juridike të kufizuar propozuesi mund ta kontestojë përdorimin e kësaj shenje vetëm në rastet e ashtuquajturit “identiteti i dyfishtë” midis markës së mëhershme të regjistruar dhe markës së shkelësit. Neni 8, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1 I LMT kërkon ekzistimin e identitetit midis (1) markave/shenjave në diskutim dhe (2) mallrave apo shërbimeve në fjalë. Ky Nen, nuk imponon provimin e mundësisë së shkaktimit të konfuzionit tek konsumatori relevant, midis markës së mëhershme dhe markës për të cilën pretendohet se shkel markën e mëparshme. Se kur dy marka mund të konsiderohen identike dallohet varësisht nëse kemi të bëjmë me markat fjalë apo marka figurative ose të përziera.

Markat fjalë janë identike në qoftë se të dy markat në diskutim janë marka fjalë dhe kanë saktësisht të njëjtën varg të shkronjave apo numrave. Nëse njëra është e paraqitur me shkronja të mëdha, ndërsa tjetra me shkronja të vogla nuk luan rol vendimtar në përcaktimin e identitetit të markave. Mirëpo nëse njëra markë është markë fjalë, ndërsa tjetra është markë figurative apo e stilizuar, atëherë nuk mund të ekzistoj identiteti i markave. Një markë fjalë dhe një markë figurative nuk mund të konsiderohen identike. Ndërsa, nëse të dy markat në diskutim janë marka figurative, atëherë që të konsiderohen identike duhet të jenë 100% të njëjta.

Prandaj bazuar në të lartcekurat, kjo gjykatë vlerëson se aktvendimi i atakuar i gjykatës së shkallës së parë nuk ka të meta për shkak të së cilave nuk mund të vlerësohet ligjshmëria e tij, sepse e njëjta me të drejtë nga vlerësimi i provave që gjenden në shkresat e lëndës ka gjetur se nuk janë përmbushur konditat ligjore të parapara me dispozitën e nenit 297.1 nën pikën a) dhe b) të LPK-së, për caktimin e masës së sigurisë.

Nga të cekurat u vendos sikurse në dispozitiv në bazë të nenit 195.1 nën pikën d) e lidhur me nenin 209 par.1 nën pikën b) të LPK-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
Ae.nr.245/2017,dt.24.10.2017

KRYETARI I KOLEGJIT,
Mahir Tutun, d.v. uli,

